



R*PUBLIKA *SHQIPËRISË
GJYKATA *RR*THIT GJYQËSOR L *ZHË*

Numri i Çështjes 71106-01486-53-2017 Data e Regjistrimit 11/10/2017
Numri i Vendimit 53-2018-14 Data e Vendimit 1/15/2018

V*NDIM
N* M * R * T * R * PUBLIKËS

GJYKATA *RR*THIT GJYQËSOR L *ZHË* P *RB* R *NGA:

KRY *SU *S* Ilir Perdeda

ANËTAR

S *KR *TAR Arta Marku

Objekti: "Dhuna ne familje"
"Prodhimi dhe mbajtja pa leje e armeve dhe municionit luftarak"

Baza Ligjore : neni 130/a/4 K.Penal, dhe 278/1 K.Penal

Përmbledhja e vendimit:

<?xml:namespace prefix = "o" ns = "urn:schemas-microsoft-com:office:office" />

Në përfundim të gjykimit, perfaqesuesia e Prokurorisë së rrethit gjyqësor Lezhe (ne tekstin vijues: *****), prokurorë Riselda Fishta, kerkoi:

- Deklarimin fajtor te pandehurit ***** per kryerjen e vepres penale te parashikuar ne nenin 130/a/4 te Kodit Penal e ne baze te kesaj dispozite denimin e tij me 18 muaj burgim;
- Deklarimin fajtor te pandehurit ***** per kryerjen e vepres penale te parashikuar ne nenin 278/3 te Kodit Penal e ne baze te kesaj dispozite denimin e tij me 14 muaj burgim;
- Ne aplikim te nenit 55 te Kodit Penal denimin e te pandehurit me 18 muaj burgim;
- Ne aplikim te nenit 403 te Kodit te Proçedures Penale uljen e 1/3 se denimit te mesiperem;
- Shpenzimet proçeduriale penale t'i ngarkohen te pandehurit;

Nga ana tjetër, mbrojtësi i te pandehurit ***** ne fjalën e fundit kerkoi qe ndaj ketij te fundit, per pjesën e denimit me burgim te mbetur pa vuajtur te aplikohet neni 59 i Kodit Penal. Po ashtu, vete i pandehuri ***** ne fjalën e fundit u shpreh dakort me kerkesën perfundimtare te mbrojtësit te tij.

***** dëmtuara nga vepra penale e parashikuar ne nenin 130/a/4 te Kodit Penal, shtetasia ***** dhe mbrojtësi i saj munguan pa dhene arsye ne diskutimin perfundimtar, ndonese ishin te pranishem ne seancat fillestare te gjykimit.

Gjykata si dëgjoji pjesmarresit dhe shqyrtoi materialin provues,

Vëren:



R*PUBLIKA *SHQIPËRISË
GJYKATA *RR*THIT GJYQËSOR L *ZHË

Akuzat e parashtruara nga ***** ne ngarkim te pandehurit ***** , ne lidhje me veprat penale te parashikuara ne nenet 130/a/4 dhe 278/3 te Kodit Penal jane te verteta nga pikpamja provuese dhe te sakta nga pikpamja e cilesimit ligjor te tyre, e per rrjedhoje i pandehuri duhet deklaruar fajtor e denuar ne lidhje me to.

Gjykimi i kesaj çeshtje e ka fillesen ne kerkesen per gjykim qe ***** ka parashtruar ne kete Gjykate me daten 17.10.2017 ne ngarkim te pandehurit ***** , ne lidhje me akuzat e parashikuara ne nenet 130/a/4 e 278/3 te Kodit Penal. Konkretisht, sipas Prokurorise rreth ores 16.00 te dates 12.7.2017, ne banesen bashkeshortore ne fshatin Zejmen te rrethit Lezhe, duke perdorur nje tub uji, me dashje i pandehuri ***** ka goditur bashkeshorten e tij ne pjese te ndryshme te trupit, perkatesisht ne krah, ije dhe gjymtyret e poshtme, duke i shkaktuar kesaj te fundit demtime fizike qe kane sjelle humbjen e perkoheshme te aftesise per pune ne masen deri 9 dite, si dhe ka mbajtur ne banese pa leje te organeve kompetente nje arme zjarri ne gjendje te rregullt teknike, me te cilin po ashtu me dashje, ne daten e oren e mesiperme, ka kercenuar per vrasje bashkeshorten e tij ***** , ndersa keto veprime te pandehurit jane nderprere per shkak se ne banese ka shkuar policia, e cila ka sekuestruar armen e zjarrit dhe arrestuar te pandehurin ***** . Per te provuar keto fakte, ***** i parashtroi Gjykates deklarimet e dhena nga e demtuara ***** perpara policise gjyqesore, proçes-verbalin e keqyrjes se jashtme te bashkeshortes se te pandehurit e kryer prej policise gjyqesore, fotot e demtimeve te jashtme te bashkeshortes se te pandehurit, akt deshmine mjekoligjore ne lidhje me demtimet e pesuara nga bashkeshortia e te pandehurit, proçes-verbalin e kontrollit te baneses se te pandehurit gjate te ciles eshte gjetur arma e zjarrit, foto te armes se zjarrit dhe te vendit ku e ka gjetur policia gjyqesore, proçes-verbalin policor te sekuestrimit te armes se zjarrit, akt-ekspertimin teknik dhe balistik te armes se zjarrit, çertifikata familjare e te pandehurit, proçes-verbalin e arrestimit ne flagrante te pandehurit dhe vendimin e gjykates per vleftesimin e ligjshem te tij dhe caktimin e mases se sigurimit "Arrest ne burg", si dhe deklarimet e te pandehurit ne hetimin paraprak (*shih fashikullin hetimor*).

Me tej, rezulton se kjo Gjykate me vendimin e seances paraprake date 1.11.2017 ka vendosur te pranoje kerkesen e Prokurorise per dergimin ne gjyq te proçedimit te mesiperme penal ndaj te pandehurit ***** , ne lidhje me dy akuzat e mesiperme (*shih vendimin nr.7 date 1.12.2017*). Rezulton se ne perfundim te hetimeve dhe gjate seances paraprake i pandehuri, mbrojtesi i tij apo bashkeshortia e te pandehurit dhe mbrojtesi i saj nuk kane pretenduar pavlefshmeri te akteve te hetimit paraprak, paperdorshmeri te provave te mesiperme te marra gjate hetimit paraprak, apo kryerjen e hetimeve shtese. ***** vëtmja kerkese e parashtruar eshte ajo e te pandehurit per gjykim te shkurtuar te çeshtjes. Po ashtu, ne seances paraprake, Gjykata kryesisht nuk ka deklaruar akte te pavlefeshme apo prova te paperdoreshme te hetimit paraprak. ***** dhe gjate ketij gjykimi, i pandehuri dhe mbrojtesi i tij, bashkeshortia e te pandehurit dhe mbrojtesi i saj, nuk kerkuan pavlefshmeri te akteve te hetimit paraprak, paperdorshmeri te provave te hetimit paraprak apo marrje provash te tjera te ndryshme nga ato te marra nga ***** ne hetimin paraprak. ***** kerkese e parashtruar nga i pandehuri dhe mbrojtesi i tij eshte ajo per gjykim te shkurtuar, te cilen e kane parashtruar ne séance paraprake dhe i qendruan edhe ne kete gjykim. Ne lidhje me kete kerkese te pandehurit, Gjykata vendosi pranimin e saj per arsye se nga shqyrtimi i fashikullit hetimor nuk u konstatuan akte absolutisht te pavlefeshme, prova te paperdoreshme dhe zgjidhja e çeshtjes ne baze te tyre eshte e mundeshme (*neni 405/6 i KPP*).<?xml:namespace prefix = "o" ns = "urn:schemas-microsoft-com:office:office" />

Duke referuar ne aktet e mesiperme te hetimit paraprak, te cilat per shkak se u pranua gjykimi i shkurtuar behen pjese e fashikullit gjyqesor, per Gjykaten provohet se i pandehuri ***** dhe e demtuara ***** jane bashkeshorte, familja e tyre kryhesohet prej te pandehurit ***** dhe ne perberje te saj bashke me



R*PUBLIKA *SHQIPËRISË

GJYKATA *RR*THIT GJYQËSOR L *ZHË

bashkeshorten bejne pjese dhe 3 femijet e tyre te mitur (*shih çertifikaten e gjendjes civile*). Per rrjedhoje, Gjykata vlereson se i pandehuri dhe bashkeshortia e tij *smëralda ***** perfshihen ne rrethin e personave qe lidhen mes tyre sipas parashikimeve te nenit 130/a te Kodit Penal.

Me tej, duke referuar ne deklarimet e te demtuares *smëralda ***** , provohet se marredheniet basheshortore te saj me te pandehurin ***** jane karakterizuar nga grindje e mosmarrveshje, te pasuara nga veprime te dhunes fizike dhe psikike te shkaktuara prej te pandehurit mbi bashkeshorten e tij, te cilat kjo e fundit nuk i ka denoncuar me pare ne polici per arsye se i pandehuri e kercononte me fjalet "do te vras po njoftove policine" duke shoqeruar perdorimin e ketyre fjaleve me pranine e nje arme zjarri te mbushur prej tij. Rasti i fundit, te cilin e demtuara *smëralda ***** e ka denoncuar ne polici, eshte ai i ores 16.00 te dates 12.7.2017, ne te cilen i pandehuri sapo ka hyre ne banese ka filluar te godase me shuplaka bashkeshorten e tij, pastaj ka marre nje tub gome dhe me te e ka goditur ne pjese te ndryshme te trupit per rreth nje ore. *dëmtuara *smëralda ***** ka mundur te telefonoje babain e saj, te cilit i ka bere me dije faktet e mesiperme, ndersa ky i fundit ka njoftuar policine. Ne kete moment i pandehuri ka shkuar ne banjon e baneses dhe ka marre nje arme zjarri qe e mbante pa leje te organeve kompetente, te cilen e ka vendosur ne tavoline, ndersa bashkeshortes se tij i ka thene "te paren do te vras ty pastaj do merrem me ato". Pas rreth 30 minutash nga kryerja e veprimeve te mesiperme, i pandehuri ka dale bashke me armen ne oborrin e baneses dhe eshte rikthyer ne banese, duke mos e patur armen me vete (*shih deklarimet e te demtuares*). Ne vend-ngjarje kane shkuar forcat policore, te cilat kane marre deklarimet e mesiperme prej te demtuares *smëralda ***** , kane kryer keqyrjen e jashtme te saj, ku kane konstatuar demtime ne traje skuqje gjatesore te njejte me ate qe rrjedh prej perdorimit te gomes se ujit ne krahun e majte te saj, ne brinjte e krahut te majte, ne shpine dhe ne gjymtyret e poshtme, gjithesej 9 hematoma, nje edeme, nje ekimozje dhe disa gervishje (*shih proçes-verbalin dhe foto*). Ne lidhje me keto demtime, eksperti mjekoligjor i caktuar nga sherbimi i policise gjyqesore, ka konkluduar se jane shkaktuar nga nje objekt tubular siq mund te jete goma qe percjell uje dhe kane sjelle humbjen e aftesise se perkoheshme per pune te demtuares *smëralda ***** ne masen deri 9 dite (*shih aktin nr.256 date 13.7.2017*).

Pervec sa me siper, rezulton se policia ka ushtruar kontroll ne banesen e te pandehurit dhe jashte saj, perkatesisht ne pjesen anesore te shkalleve hyrese ne banese ka gjetur e sekuestruar nje arme zjarri me nr.11443478, ne kreherin e te ciles gjendeshin 11 fisheke, prej te cileve njeri i vendosur ne folene e qytes se armes (*shih proçes-verbalet dhe foto*). Ne lidhje me kete arme, eksperti kriminalist i caktuar nga policia gjyqesore ka konkluduar se eshte pushke gjysem automatike luftarake e modelit 56 kaliber 7.62 mm, me qyte te shkurtuar, por qe realizon qitje normalisht. Po ashtu, 11 fisheket jane fisheke standart luftarak te modelit 56 kaliber 7.62 mm qe perdoren si municion dhe nga pushket e modelit 56, jane te rregullt teknkisht dhe te pershatshem per te realizuar qitje (*shih aktin nr.8824 date 15.8.2017*). I pyetur gjate hetimit paraparak, i pandehuri ka pranuar qe arma e zjarrit e mesiperme mbahej prej tij pa leje te organeveve kompetente dhe ne lidhje me kete veprim ishte i penduar (*shih proçes-verbalin e deklarimeve*).

Se fundi, provohet se ne lidhje me faktet e mesiperme me daten 12.7.2017 policia gjyqesore ka vendosur arrestimin ne flagrante te pandehurit ***** (*shih proçes-verbalin*), ndersa kjo Gjykate me vendimin penal nr.204 date 14.7.2017 e ka vleftesuar te ligjshem arrestin policor dhe ndaj te pandehurit ka caktuar masen e sigurimit "Arrest ne burg", e cila vijon te jete ne fuqi (*shih vendimin*).

Per Gjykaten, provat e mesiperme lidhen mes tyre, duke permbushur standartin provues qe diktojne vertetimi i akuzave ne ngarkim te pandehurit ***** , dhe vertetojne se ky i fundit me dashje e pa leje te organeve kompetente policore, ne kundërshtim me nenin



R*PUBLIKA *SHQIPËRISË
GJYKATA *RR*THIT GJYQËSOR L *ZHË

278/3 te Kodit Penal, me daten 12.7.2017 ka mbajtur ne banesen e tij ne fshatin Zejmen, Lezhe nje arme zjarri luftarake te tipit pushke gjysem automatike ne gjendje te rregullt teknike. Po ashtu, faktet e deklaruar nga e demtuara ***** shërnalda ***** konfirmohen nga gjurmet e demtimeve te konstatuara nga policia gjyqesore dhe eksperti mjeko-ligjor ne trupin e saj, duke vertetuar jashte çdo dyshimi te arsyeshem se rreth ores 16.00 te dates 12.7.2017, ne banesen bashkeshortore ne Zejmen, Lezhe, me dashje i pandehuri ***** ***** ka ushtruar dhune fizike ndaj saj, ne formen e goditjes me shuplake dhe tubo uji, si dhe dhune psikologjike, ne formen e kercenimit me fjale dhe prani te armes se zjarrit. Po ashtu, mbi bazen e besueshmerise ee fakteve te mesiperme, Gjykata vlereson se e demtuara ***** shërnalda ***** eshte e besueshme dhe ne lidhje me faktet e deklaruar prej saj se i pandehuri ka ushtruar dhe here te tjera ne menyre te perseritur dhune fizike e psikologjike mbi te. Per Gjykatën, veprimet e mesiperme qe i pandehuri ***** ***** ka kryer mbi bashkeshorten e tij perbejne shkelje te nenit 130/a/4 te Kodit Penal dhe ne rrethanat qe ndaj te pandehurit nuk vertetohen shkaqe per perjashtimin e tij nga pergjegjesia e denimin penal, ky i fundit duhet deklaruar fajtor e denuar penalisht per kryerjen e veprave penale te parashikuara ne nenet 278/3 e 130/a/4 te Kodit Penal.

Ne lidhje me llojin e masen e denimit qe i duhet caktuar te pandehurit, Gjykata mban ne konsiderate rrezikshmerine shoqerore jo shume te larte te veprave penale te kryera prej tij, faktin se prej tij eshte kryer me shume se nje veper penale, rrethane kjo qe rendon denimin e tij, qenien e te pandehurit i padenuar me pare, pendimin e thelle te treguar prej tij gjate gjithë rrjedhes se hetimit e gjykimit, gjendjen dhe pergjegjesine e tij si kryefamiljar, i cili duhet te kujdeset per rritjen e edukimin e 3 femijeve te mitur, rrethana keto qe duhet te lehtësojne denimin e tij.

Për keto arsye:

Baza Ligjore:

Bazuar ne nenin 390 te Kodit te Proçedures Penale, Gjykata, <?xml:namespace prefix = "o" ns = "urn:schemas-microsoft-com:office:office" />



R*PUBLIKA *SHQIPËRISË
GJYKATA *RR*THIT GJYQËSOR L *ZHË

Vendosi:

Deklarimin fajtor te pandehurit ***** per kryerjen e vepre penale "dhuna ne familje" e ne baze te nenit 130/a /4 i Kodit Penal e denon me 15 muaj burgim.

Deklarimin fajtor te pandehurit ***** per kryerjen e vepres penale "mbajta pa leje e armeve shperthyese dhe municionit" dhe ne baze te nenit 278/3 i kodit penal e denon me 1 vit burgim.

Ne apikim te nenit 55 te kodit penal ne bashkim te denimeve i pandehuri ***** denohet me nje denim te vetem prej me 15 muaj burgim.

Ne aplikim te nenit 406 te kodit te procedure spenale duke i ulur 1/3 e denimit te mesiperm i pandehurit ***** denohet me 10 muaj burgim. Vuajta e denimit fillon me daten 12.7.2017 dhe do te kryhet ne burg te sigurise se zakonshme.

Arma e zjarrit prove materiale do ti kaloje Komisarariatit te Policise lezhe.

Shpenzimet proceduriale penale i ngarkohen te pandehurit.

Kunder vendimit lejohet ankim ne Gjykatën e Apelit Shkoder brenda 15 diteve duke filluar ky afat nga e nesermja e shpalljes se vendimit

Ky dokument është marrë nga www.gjkata.gov.al. Ai ka vlerë të plotë informuese, por nuk shërben si dokument zyrtar. Ky i fundit lëshohet nga autoritetet përkatëse.